



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

NDRYSHIMET LIGJORE SIPAS LIGJIT Nr. 08/L-257 PËR ADMINISTRIMIN E PROCEDURAVE TATIMORE

Sami Salihu – zv. Zëvendësdrejtor Ekzekutiv i ATK

Janar 2024

Neni 1 - Qëllimi

- Është shtuar neni: Qëllimi, pasi që në Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat nuk ekziston.
- **Qëllimi** - Ky Ligj rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të ATK.

Neni 2 - Fushëveprimi

- Është shtuar neni: Fushëveprimi, pasi që në Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat nuk ekziston.
- **Fushëveprimi** - Dispozitat e këtij Ligji janë të obligueshme për të gjithë personat që i nënshtrohen fushëveprimit të këtij Ligji, për ATK dhe institucionet tjera të përcaktuara me këtë Ligj.

Neni 3 - Përkufizimet

- Janë shtuar disa përkufizime të reja, si: Detyrim tatimor, Faturë fiktive, Hetimet administrative, Numër Fiskal, Numër Unik Identifikues, Operator Ekonomik, Organizatë Afariste, Shoqëri e personave, Transaksion fiktiv, etj., si dhe janë riformuluar disa nga përkufizimet aktuale:
 - 1.6. **Detyrim tatimor** - obligimin për të paguar lidhur me realizimin e të ardhurave të tatueshme sipas legjislacionit tatimor në fuqi.
 - 1.10. **Faturë fiktive** – faturën e lëshuar në rastet kur transaksioni/furnizimi i mallit dhe/ose shërbimit, nuk ka ndodhur.
 - 1.11. **Hetimet administrative** – çdo inspektim, kontroll apo masë tjetër e ndërmarrë nga organi administrativ për të identifikuar natyrën e parregullt të veprimtarive nën hetim, për aq kohë sa këto hetime nuk bien ndesh me kompetencat e Prokurorisë së Shtetit për të iniciuar hetimet penale.
 - 1.18. **Numër Fiskal** – numrin me të cilin ATK pajis tatimpaguesin dhe që përdoret vetëm për qëllime tatimore;
 - 1.19. **Numër Unik Identifikues** – numrin e regjistrimit me të cilin organizata afariste është pajisur nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.
 - 1.21. **Operator Ekonomik** – kompaninë e autorizuar nga organi kompetent, për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të PEF/SF.

Neni 3 – Përkufizimet (vazhdim)

- 1.22. **Organizatë Afariste** – termin e përgjithshëm dhe përbën çdo lloj të shoqërive tregtare të themeluara në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.41. **Shoqëri e personave** – dy apo më shumë individë, kompani, organizata, qeveri apo çdo kombinim i këtyre entiteteve me qëllim të pjesëmarrjes në një aktivitet të përbashkët apo grupim i burimeve të tyre për arritjen e një qëllimi të përbashkët, ku secili pjesëmarrës mban statusin juridik të vetin të ndarë dhe kontrolli i shoqërisë mbi secilin pjesëmarrës është përgjithësisht i kufizuar në aktivitetet që përfshin përpjekjen e përbashkët, në veçanti ndarjen e fitimeve, dhe e cila është e themeluar me një kontratë, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e secilit anëtar;
- 1.44. **Transaksion fiktiv** - veprimin financiar kur transaksioni nuk ka ndodhur, pra kur nuk ka ndodhur furnizimi i mallit dhe/ose shërbimit.

Neni 4 - Numri Fiskal dhe pajisja me Certifikatë Fiskale

- Është shtuar dispozita ligjore që në rastet kur personi zhvillon aktivitet ekonomik dhe kërkohet të regjistrohet në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), nuk kërkohet të pajiset edhe me Numër Fiskal në ATK.
 - 2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, personi i cili zhvillon aktivitet ekonomik dhe kërkohet të regjistrohet në ARBK, nuk kërkohet të pajiset edhe me numër fiskal.

Neni 5 - Çregjistrimi i Tatimpaguesit

- Janë përcaktuar kriteret kur Tatimpaguesi mund të kërkoj të çregjistrohet. Tatimpaguesi ka të drejtë të parashtoj kërkesë për çregjistrim vetëm pasi të ketë:
 - 1.1. deklaruar dhe paguar të gjitha detyrimet tatimore;
 - 1.2. paraqitur bilancin e mbylljes ose regjistrimet tjera të kërkuara; dhe
 - 1.3. çregjistruar PEF/SF.
- Është shkurtuar koha për shqyrtim të kërkesës për çregjistrim nga ATK, nga 60 ditë në 45 ditë.
 - 2. Administrata Tatimore e Kosovës, brenda dyzetepesë (45) ditëve nga data e kërkesës për çregjistrim, verifikon gjendjen tatimore dhe kur është e nevojshme ushtron kontrollin e veprimtarisë së tatimpaguesit.
 - 3. Brenda dyzetepesë (45) ditëve nga data e kërkesës për çregjistrim, nëse ATK vlerëson se tatimpaguesi nuk i plotëson kushtet për çregjistrim sipas paragrafit 1 të këtij neni, nxjerrë njoftim me shkrim dhe ia dorëzon tatimpaguesit.
- Administrata Tatimore e Kosovës mund të çregjistrojë nga regjistri i saj aktiv çdo tatimpagues kur provohet se ai për çfarëdo arsye në dymbëdhjetë (12) muajt e fundit nuk ka ushtruar veprimtari. Pra, ndryshimi është nga “viti i fundit fiskal” në “dymbëdhjetë (12) muajt e fundit”.
 - 6. Administrata Tatimore e Kosovës mund të çregjistrojë nga regjistri i saj aktiv çdo tatimpagues kur provohet se ai për çfarëdo arsye në dymbëdhjetë (12) muajt e fundit nuk ka ushtruar veprimtari. Në këtë rast, këta tatimpagues vihen në një regjistër të veçantë të tatimpaguesve joaktiv dhe ATK njofton ARBK në lidhje me atë regjistër.

Neni 6 - Krijimi dhe mbajtja e regjistrave

- Është shtuar dispozita që regjistrat që lidhen me shërbimet elektronike duhet të mbahen për një periudhë prej së paku dhjetë (10) vite pas përfundimit të periudhës tatimore kur janë ofruar shërbimet elektronike.
- Është shtuar dispozita që regjistrat që lidhen me transaksionet e arit të investueshëm duhet të mbahen për një periudhë prej së paku dhjetë (10) vite.
- Çdo transaksion mbi treqind euro (300€) i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare dhe/ose formave tjera të pagesës në mënyrë elektronike. Po ashtu, edhe për pagesat e pjeshme me para dhe pjesa tjetër me kompensim, kur transaksioni është mbi 300€ vlen rregulla e njëjtë. Pra, ndryshimi është ulja e vlerës së transaksionit nga 500€ në 300€, si dhe mundësia e pagesës edhe përmes mënyrës elektronike e jo vetëm përmes llogarisë bankare.
- Është shtuar dispozita edhe për transaksionet nga biznesi për individin, si: Çdo transaksion mbi vlerën e përcaktuar me vendim nga Ministri, i bërë në mes të personit që zhvillon aktivitet ekonomik dhe personit fizik jo afarist, kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare dhe/ose formave tjera të pagesës në mënyrë elektronike.
- Është shtuar dispozita që pagat të paguhen përmes institucioneve financiare, si: Çdo pagë që i paguhet të punësuarit, kërkohet të bëhet përmes një institucioni financiar të licencuar.

Neni 7 - Operatori Ekonomik i autorizuar për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të PEF/SF

- Është shtuar nen i veçantë për detyrimet e Operatorëve Ekonomik të autorizuar për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të Pajisjeve Elektronike Fiskale/ Sistemeve Fiskale.
 - 1. Operatori Ekonomik i Autorizuar për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të PEF/SF duhet:
 - 1.1. të garantojë punën me një garanci bankare apo formë tjetër të garantimit të pranueshëm;
 - 1.2. të ri-licenohet çdo katër (4) vite nga ATK;
 - 1.3. që modelet e PEF/SF të aprovuara, t'i ricertifikojë nga organi kompetent çdo katër (4) vite;
 - 2. Në rastet kur Operatori Ekonomik nuk arrin të Certifikojë së paku një model të PEF/SF nga organi kompetent brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga data e marrjes së Autorizimit nga ATK, i anulohet Autorizimi si Operator Ekonomik.
 - 3. Kryesi i shërbimeve është i obliguar që t'iu përgjigjet të gjitha kërkesave të tatimpaguesve për t'u pajisur me PEF/SF në afatin më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për furnizim me pajisje.
 - 4. Kryesi i shërbimeve është i obliguar të bëjë intervenimet dhe mënjanimin e mosfunksionimit të PEF/SF sipas kërkesave të tatimpaguesve dhe ATK për servisim dhe mirëmbajtje të PEF/SF, në afat jo më të largët se dyzetetë (48) orë nga momenti i paraqitjes së problemit.
 - 5. Ministri nxjerrë akt nënligjor për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen, administrimin, vendosjen dhe përdorimin e PEF/SF.

Neni 8 - Qasja në libra, regjistra, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave

- Është shtuar dispozita për qasje në informata të tatimpaguesit të ruajtura tek palët e treta: Administrata Tatimore e Kosovës, do të ketë qasje edhe tek palët e treta, të cilat mbajnë dhe ruajnë dokumentacionin e tatimpaguesit, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
 - 1.1. Administrata Tatimore e Kosovës, do të ketë qasje edhe tek palët e treta, të cilat mbajnë dhe ruajnë dokumentacionin e tatimpaguesit, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
- Është shtuar dispozita që Tatimpaguesi siguron që pala e tretë i ofron qasje të plotë dhe të lirë ATK në informatat dhe dokumentacionin e tatimpaguesit.
 - 1.2. Tatimpaguesi siguron që pala e tretë i ofron qasje të plotë dhe të lirë ATK në informatat dhe dokumentacionin e tatimpaguesit.
- Është shtuar dispozita që një zyrtar tatimor i cili ushtron një autorizim sipas këtij neni, nuk ka të drejtë të hyjë ose të qëndrojë në ndonjë objekt, nëse pas kërkesës së tatimpaguesit, zyrtari tatimor nuk paraqet autorizimin e tij. Autorizim sipas këtij neni konsiderohet kartela zyrtare nga ATK ose çfarëdo forme tjetër e përcaktuar nga ATK.

Neni 9 - Mbledhja e informatave ose provave

- Është shtuar dispozita që për qëllime të mbikëqyrjes së fakteve që janë relevante me tatime, institucionet financiare duhet të dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha transaksionet vendore dhe ndërkombëtare, në valutën vendore dhe të huaj, të llogarive të personave juridik, personave fizikë afarist dhe jo-afarist, përfshirë këtu edhe depozitat e kursimeve.
- Është shtuar dispozita që për qëllime të mbikëqyrjes së fakteve që janë relevante me tatime, Noterët duhet të dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha kontratat e shitblerjeve nga personat juridik, personat fizikë afarist dhe personat fizikë jo-afarist.
- Është shtuar dispozita, si: Informatat bankare nga institucionet financiare të licencuara, mund të kërkohen në mënyrë individuale, grupore apo në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar me ndonjë ligj të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
- Është shtuar dispozita, si: Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë që për qëllime tatimore të përdorë informata në formë të fotove të momentit apo video incizime, të bëra nga publikimet e tatimpaguesit.

Neni 10 - Shkëmbimi i informacionit për qëllime ndërkombëtare

- Është shtuar një nen i veçantë për shkëmbim të informacionit për qëllime ndërkombëtare.
 - 1. Me kërkesë të ATK, çdo person duhet të sigurojë çdo informacion, përfshirë por pa u kufizuar në informacionin e mbajtur nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, të cilat mund të kërkohen për qëllimet e një konvente ndërkombëtare për çështjet tatimore, përfshirë Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD), Marrëveshjet për Shkëmbimin e Informatave Tatimore (MSHIT) ose për qëllimin e një marrëveshje ndërkombëtare që ofron ndihmë administrative në çështjet tatimore (në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshje Ndërkombëtare).
 - 2. Pa kufizim të detyrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen të njëjtat rregulla si për informacionin përkatës për qëllimet e tatimeve vendore, përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshjen Ndërkombëtare, sipas së cilës kërkohet informacioni.
 - 3. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.

Neni 11 - Negociatat për Marrëveshje Ndërkombëtare

- Është shtuar një nen i veçantë tek Negociatat për Marrëveshje Ndërkombëtare.
 - 1. Negociatat për Marrëveshje Ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe çështje të tjera të lidhura me tatimin dhe nënshkrimi i tyre në nivelin teknik bëhet nga Ministria përgjegjëse për Financa (në tekstin e mëtejme: Ministria) në bashkëpunim me ATK në përputhje me dispozitat e Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
 - 2. Zbatimi i dispozitave të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ose konventave në fushën e tatimeve, bëhet nga ATK.

Neni 12 - Obligimet e përfaqësuesve juridik dhe menaxherëve të pasurisë

- Është shtuar dispozita për Këshilltar Tatimor i cili është një person me trajnim të avancuar dhe njohuri të legjislacionit tatimor që ndihmon tatimpaguesin gjatë procedurave tatimore në mënyrë që deklaratat tatimore të jenë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të përfitojnë nga zbritjet dhe rimbursimet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- Administrata Tatimore e Kosovës bën licencimin e Këshilltarëve Tatimor pas përfundimit të trajnimit dhe testimit të suksesshëm.

Neni 13 - Deklaratat tatimore

- Është riformuluar neni: Deklaratat tatimore.

Neni 14 - Vetëvlerësimi

- Tatimpaguesi mund të dorëzojë një ndryshim të deklaratës tatimore, brenda tre (3) viteve pas datës obligative kur deklarata është kërkuar të dorëzohet fillimisht, nëse më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar paraprakisht. Pra, është shkurtuar koha nga 6 vite në 3 vite për të mundësuar korrigjimet nga tatimpaguesi.
- Është shtuar paragraf i ri, i cili përcakton rregull/kufizim për ndryshimin e deklaratës së TVSH:
 - 6. Në zbatim të paragrafit 2 të këtij neni, ndryshimi i deklaratës tatimore për TVSh për ndonjë periudhë tatimore më të hershme se sa periudha e vlerësuar nga ATK, lejohet vetëm me aprovimin nga ATK.

Neni 15 - Vlerësimi i ATK për tatimin

- Është shtuar dispozita e cila përcakton që për të lejuar si zbritje nga të ardhurat bruto një shpenzim i cili lidhet me tatimin e mbajtur në burim, është i kushtëzuar që të ndodh edhe pagesa.
 - 10. Përfshirë nga paragrafi 9 i këtij neni, bëjnë shpenzimet që lidhen me tatimin e mbajtur në burim, të cilat kushtëzohen me pagesë.
- Është shtuar dispozita që kur ATK vlerëson se transaksioni është fiktiv, për qëllime tatimore nuk do të njihet si shpenzim nga të ardhurat dhe/ose kreditim për TVSh.
- Është shtuar dispozita që në rastin e një rikontrolli sipas vendimit të Ankesave, Bordit apo Gjykatës, rikontrolli nuk mund të bëhet nga zyrtari tatimor dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, të cilët kanë marrë pjesë në vlerësimin e parë.
- Është shtuar dispozita e cila përcakton qarkullimin mujor të padeklaruar bazuar në informatat nga analiza e riskut, si dhe përcakton aplikimin e ndëshkimit:
 - 17. Në rastet kur ATK bazuar në informatat nga analiza e riskut bën inspektime dhe vëzhgime të tatimpaguesi dhe konstaton se tatimpaguesi ka nëndeklaruar qarkullimin ditor, diferenca e qarkullimit ditor do të përlogaritet për ditët e punës të asaj periudhe që punon biznesi dhe do të konsiderohet qarkullim mujor i padeklaruar, mbi bazën e së cilës do të aplikohet gjoba e përcaktuar në nenin 100: “Gjobat lidhur me nën deklarimin e tatimit dhe mbi deklarimin e rimbursimeve apo kreditimeve tatimore”, paragrafin 3, ndëshkimi 25% i vlerës së nëndeklaruar”.

Neni 19 - Anulimi i dokumenteve tatimore

- Është shtuar dispozita që çdo herë kur ATK gjatë verifikimit të dokumentacionit identifikon ndonjë transaksion/faturë fiktive, pavarësisht se a është biznesi që ka lidhur transaksionin/lëshuar faturën i publikuar në ueb-faqe të ATK-së apo jo, ai transaksion/ajo faturë nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së shpenzimeve në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së TVSh së zbritshme, si dhe për të dy bizneset, si: për biznesin i cili e ka lëshuar faturën për transaksionin fiktiv dhe biznesin që e ka pranuar faturën për transaksionin fiktiv, ATK do të ndër marrë masat e përcaktuara me Legjislacionin në fuqi.

Neni 23 - Pagesat

- Është shtuar dispozita që Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë të përdor llogari kalimtare për pranimin dhe shpërndarjen e pagesave.
- Është fshirë paragrafi 7 i Nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sipas të cilit, aty ku shuma e tatimit për pagesë sipas një deklaratë tatimore është tre (3) Euro ose më pak, ose shumë tjetër të tillë të vogël e përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ATK do të trajtojë tatimin e pagueshëm si vlerë zero.

Neni 24 - Interesi

- Është shtuar dispozita sipas së cilës vendoset kufizimi për kalkulimin e interesit për pagesën e vonuar, si:
- Interesi llogaritet në bazë mujore, për çdo muaj apo pjesë të muajit nga data kur tatimi është bërë i detyrueshëm për pagesë deri në datën kur tatimi paguhet, por jo më shumë se dhjetë (10) vite nga data kur tatimi është bërë i detyrueshëm për pagesë. Pra, me riformulimin e kësaj dispozite ndërpritet interesi në periudhën prej 10 viteve, në krahasim me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat që interesi vazhdonte të llogaritet pa ndonjë kufizim.

Neni 25 - Rendi i pagesave

- Është ndryshuar renditja e pagesave dhe tani shuma e ndonjë tatimi të paguar në përputhje me këtë Ligj shpërndahet sipas rendit vijues:
 1. shpenzimet e mbledhjes;
 2. shuma e çdo obligimi tatimor;
 3. interesi; dhe
 4. ndëshkimet/gjobat.

Pra, ajo që ka ndryshuar është interesi dhe ndëshkimet/gjobat, ku sipas Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat interesi është i fundit, ndërsa ndëshkimet/gjobat janë të parafundit.

- Është riformuluar dispozita që në rastet kur detyrimi më i hershëm është për ndonjë lloj tatimi dhe kontribut pensional apo kontribut tjetër, për të njëjtën periudhë tatimore, pagesa shpërndahet fillimisht për të përmbushur detyrimin në tatime pastaj vazhdohet me shpërndarjen e pagesave në kontribute pensionale dhe kontribute tjera.

Neni 26 - Kreditimet dhe rimbursimet

- Kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda tre (3) vitesh nga data kur është paguar tatimi apo kur ka lindur e drejta e zbritjes. Pra, zvogëlim i periudhës nga 6 vite në 3 vite.
- Është shkurtuar afati për shqyrtimin e kërkesës për Rimbursim nga 60 ditë në 30 ditë.
- Është shkurtuar afati për fillimin e aplikimit të interesit për Rimbursimin e vonuar nga dita e 61-të në ditën 31-të.
- Është shtuar dispozita që në raste kur tatimpaguesi ka balancë kreditore për më shumë se tre muaj radhazi dhe ka borxh tatimor për më shumë se pesëmijë euro (5,000€), ATK njofton tatimpaguesin se do të iniciojë një vlerësim të kreditimit të TVSh dhe nëse kreditimi është përcaktuar të jetë i vlefshëm, një shumë e kreditimit deri në shumën e detyrimit tatimor do të aplikohet në detyrimin tatimor dhe mbetja do të rimbursohet.

Neni 29 - Barra tatimore

- ATK ka të drejtë të vendos barrën tatimore në tërë pasurinë e personit, përfshirë edhe pasurinë e blerë nga personi pas vendosjes së barrës tatimore, për të siguruar obligimin tatimor të papaguar, i cili përfshin tatimin e papaguar, ndëshkimet/gjobat, interesin dhe shpenzimet e mbledhjes.
- Është ndryshuar ora për vendosjen e Barrës tatimore nga ora 17:00 siç ishte në Ligjin Nr. 03/L-222, në vendosjen e Barrës në fund të orarit të punës në ditën e dhjetë, kur tatimi vlerësohet që nuk është paguar, si dhe lidhet edhe me borxhin e krijuar gjatë ekzistimit të barrës tatimore dhe vazhdon të mbetet në fuqi derisa detyrimi të jetë shlyer ose bëhet i pa mbledhshëm.
- Është përcaktuar që Barra tatimore përfundon dhjetë (10) vite nga data e vlerësimit dhe obligimi tatimor më nuk do të jetë i mbledhshëm pas asaj date, me përjashtim të rrethanave të përcaktuara në nën-paragraf. Pra, është ndryshuar afati nga 6 vite në 10 vite.
- Është shtuar paragrafi që Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë që pas vitit të dhjetë (10) nga vendosja e barrës sipas paragrafit 2 të këtij neni, të bëjë rivlerësimin e pasurisë me barrë tatimore dhe pasuria e cila vlerësohet që mbulon detyrimin e pashlyer dhe e cila është konfiskuar në bazë të procedurave të mbledhjes së detyrueshme, kalon në pronë shtetërore.
- Është shtuar paragrafi që Administrata Tatimore e Kosovës mund të angazhojë Operatorë Ekonomik për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar.

Neni 37 - Vendimi për publikim

- Është shtuar nen i ri sipas të cilit Administrata Tatimore e Kosovës mund të nxjerrë vendim për publikimin e listës për tatimpaguesit që nga kontrollet e ATK kanë rezultuar në shmangie tatimore, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Drejtori i ATK nxjerrë vendim për përcaktimin e kriterëve për publikim në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 43 - Shkëmbimi i transaksioneve dhe raportimi i informatave nga palët e treta

- Është shtuar dispozita sipas së cilës të gjithë personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe aktivitete tjera, duhet të dorëzojnë në ATK, në mënyrë elektronike librin e blerjes dhe librin e shitjes, si:
 - Personat që janë të regjistruar për TVSH, dorëzojnë librat çdo muaj;
 - Personat tjerë, dorëzojnë librat çdo tre muaj.
- Është fshirë dispozita e cila sipas Nenit 47, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-222 kërkohej të raportohet për transaksionet mbi 500€, si:
 3. Të gjithë personat e angazhuar në tregti ose afarizëm të cilët taten në bazë të të hyrave reale dhe që bëjnë blerje të mallrave ose shërbimeve (apo marrin mallra ose shërbime në një barter transaksion) nga personi tjetër i tatueshëm në gjithsejtë pesëqind (500) Euro e më shumë në çdo vit të tatueshëm, duhet të paraqesin deklaratë të vërtetë dhe të saktë duke raportuar blerjet e tilla tek ATK-ja. Blerjet e bëra nga Qeveria dhe komunat e Republikës së Kosovës gjithashtu i nënshtrohen këtyre kërkesave për raportim. Deklaratat vjetore obliguese me këtë nen do të dorëzohen në ATK, por jo më larg se 31 Mars të vitit vijues.
- Është shtuar dispozita sipas së cilës çdo punëdhënës duhet të informojë ATK për lidhjen e një kontrate të punës një ditë para fillimit të punës së punëtorit. Ky informim bëhet në formën e përcaktuar nga ATK.

Kapitulli VII: Kuadri Ligjor dhe Institucional tatimor

Nënkapitulli I: Organizimi dhe funksionimi i Administratës Tatimore të Kosovës

- Është riformuluar komplet Kapitulli për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Tatimore të Kosovës, përfshirë:
 - Nenin 45: Legjislacioni Tatimor;
 - Nenin 46: Administrata Tatimore e Kosovës;
 - Nenin 47: Organizimi i Administratës Tatimore të Kosovës;
 - Nenin 48: Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës;
 - Nenin 49: Delegimi i kompetencave;
 - Nenin 50: Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm;
 - Nenin 51: Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm;
 - Nenin 52: Përfundimi i mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm;
 - Nenin 53: Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
 - Nenin 54: Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm;
 - Nenin 55: Përfundimi i mandatit të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 56 - Hetimet Tatimore dhe Inteligjenca

- Është riformuluar neni për Hetimet Tatimore dhe Inteligjenca.

Neni 58 - Avokati i Tatimpaguesve

- Është shtuar neni për Avokatin e Tatimpaguesve duke i përshkruar kompetencat/funksionet.

Neni 59 - Standardet Profesionale

- Është riformuluar neni për Standardet Profesionale me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të Kodit të Etikës nga zyrtarët tatimor dhe nëpunësit e tjerë brenda ATK.

Neni 60 - Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative

- Është shtuar nen i ri në bazë të të cilit Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj funksionimin e Zyrës për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative (ZGjoNA), e cila trajton shkeljet ligjore për të gjitha të gjeturat nga njësitë operative, si dhe nxjerr vendime që kanë të bëjnë me ndëshkime dhe gjoba të përcaktuara në legjislacionin tatimor.

Neni 61 - Bordi i Ankesave

- Është shtuar nen i ri për themelimin e Bordit të Ankesave në Ministri për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të nxjerra nga Njësia e Ankesave në ATK dhe Doganë të Kosovës, lidhur me çështjet tatimore dhe doganore.

Neni 62 - Juridiksioni i Bordit

- Është shtuar nen i ri sipas të cilit Bordi ka juridiksion të shqyrtojë çdo vendim nga njësitë përkatëse të ankesave në lidhje me legjislacionin tatimor dhe doganor në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 66 - Konfidencialiteti i informatave tatimore

- Është riformuluar neni për Konfidencialitetin e informatave tatimore.

Nënkapitulli II: Marrëdhënia e punës në Administratën Tatimore të Kosovës

- Është shtuar Kapitulli për Marrëdhënien e punës në Administratën Tatimore të Kosovës, përfshirë:
 - Nenin 67: Regjimi juridik i marrëdhënies së punës së punonjësit të ATK;
 - Nenin 68: Klasifikimi i vendeve të punës;
 - Nenin 69: Plani i Rekrutimit;
 - Nenin 70: Konkurrimi;
 - Nenin 71: Komisioni për zhvillimin e procedurave të punësimit;
 - Nenin 72: Kushtet për pranimin në marrëdhënie pune të zyrtarit tatimor;
 - Nenin 73: Kohëzgjatja e akteve të marrëdhënies së punës;
 - Nenin 74: Periudha provuese;
 - Nenin 75: Avancimi në karrierë i zyrtarit tatimor;
 - Nenin 76: Akti i brendshëm për pranimin dhe karrierën në ATK;
 - Nenin 77: Vlerësimi i rezultateve të punës;
 - Nenin 78: Emërimet e përkohshme;

Nënkapitulli II: Marrëdhënia e punës në Administratën Tatimore të Kosovës

- Është shtuar Kapitulli për Marrëdhënien e punës në Administratën Tatimore të Kosovës, përfshirë:
 - Nenin 79: Emërimi dhe mandati i pozitave drejtuese;
 - Nenin 80: Transferimi;
 - Nenin 81: Riorganizimi;
 - Nenin 82: Orari i punës dhe pushimet;
 - Nenin 83: Pezullimi i marrëdhënies së punës;
 - Nenin 84: Përfundimi i marrëdhënies së punës;
 - Nenin 85: Parandalimi i konfliktit të Interesit;
 - Nenin 86: Kufizimi i shfrytëzimit të informatave;
 - Nenin 87: Përgjegjësia dhe shkeljet disiplinore;
 - Nenin 88: Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës;
 - Nenin 89: Shqyrtimi i përgjegjësisë disiplinore dhe mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënia e punës;
 - Nenin 90: Shuarja e masave disiplinore;
 - Nenin 91: Akti i brendshëm për disiplinën dhe ankesat e punonjësve të ATK.

Neni 99 - Gjobat lidhur me mosdeklarim

- Është riformuluar neni Gjobat lidhur me mosdeklarimin, duke ndryshuar aplikimin e ndëshkimeve. Riformulimi, si:

Kur një person nuk e dorëzon një deklaratë tatimore të obligueshme sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës në afatin e përcaktuar, e cila rezulton me detyrim tatimor, i nënshtrohet gjobës prej:

- Pesëdhjetë euro (50.00€) për personin fizik afarist, për çdo deklaratë të pa deklaruar;
- Njëqindpesëdhjetë euro (150.00€) për personin juridik, për çdo deklaratë të padeklaruar;
- Njëzet euro (20.00€) për personin fizik jo afarist, për çdo deklaratë të padeklaruar.

Neni 100 - Gjobat lidhur me nën deklarimin e tatimit dhe mbi deklarimin e rimbursimeve apo kreditimeve tatimore

- Në këtë nen, përveç gjobës për nën deklarim të tatimit dhe mbi deklarim të rimbursimit, është shtuar edhe gjoba për mbi deklarim të kreditimit tatimor.
- Është shtuar dispozitë e re që në rastet kur aplikohen gjobat sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 të nenit 100, nuk aplikohen edhe gjobat e përcaktuara në nenin 101. Pra, në rastet kur aplikohen gjobat prej 15% apo 25% për nën deklarimin e tatimit dhe mbi deklarimin e rimbursimeve apo kreditimeve tatimore, nuk mund të aplikohen edhe gjobat për mos dorëzim, mos krijim ose mos paraqitje të të dhënave.

Neni 101 - Sanksionet për mos dorëzim, mos krijim ose mos paraqitje të të dhënave

- Është riformuluar neni Sanksionet për mos dorëzim, mos krijim ose mos paraqitje të të dhënave, duke rritur vlerën e gjobave dhe harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje, si:
 - gjobë prej njëqindpesëdhjetë euro (150.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor deri në tridhjetëmijë euro (30,000.00€);
 - gjobë prej dyqindpesëdhjetë euro (250.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga tridhjetëmijë euro e një cent (30,000.01€) deri në dyqindmijë euro (200,000.00€);
 - gjobë prej pesëqind euro (500.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga dyqindmijë euro e një cent (200,000.01€) deri në pesëqindmijë euro (500,000.00€);
 - gjobë prej njëmijë euro (1,000.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga pesëqindmijë euro e një cent (500,000.01€) deri në pesëmilion euro (5,000,000.00€); dhe
 - gjobë prej dymijë euro (2,000.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor prej pesëmilionë euro e një cent (5,000,000.01€) e më shumë.

Neni 101 - Sanksionet për mosdorëzim, moskrijim ose mos paraqitje të të dhënave

- Është shtuar dispozitë e re që për personat të cilët nuk lëshojnë kuponë fiskal me rastin e furnizimit të mallrave dhe/apo shërbimeve, ATK ndalon ushtrimin e veprimtarisë së biznesit në pikat e shitjes në rastet kur aplikohen ndëshkime të vazhdueshme, si:
 - shtatë (7) ditë kalendarike në rastet kur aplikohen tre (3) ndëshkime në data të ndryshme brenda vitit kalendarik;
 - pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike në rastet kur aplikohen katër (4) ndëshkime në data të ndryshme brenda vitit kalendarik;
- Është shtuar dispozita që për çdo person i cili nuk përditëson informatat siç kërkohet me ligj, i nënshtrohet një gjobe prej njëqindpesëdhjetë euro (150.00€).
- Është shtuar dispozita që për çdo person i cili pranon pagesë në kundërshtim me Ligjin (pagesë të pranuar jo përmes llogarisë bankare apo forma tjera të pagesës elektronike), i nënshtrohet gjobës sipas qarkullimit vjetor.

Neni 102 - Gjoha për mos ofrimin e informatave dhe provave

- Janë përcaktuar gjohat në rastet kur nuk ofrohen informatat ose provat.
- Është shtuar dispozitë e re, sipas së cilës çdo punëdhënës, i cili nuk informon ATK për punëtorin e punësuar, i nënshtrohet një gjobe prej pesëqind euro (500.00€) për secilin punëtor të padeklaruar.

Neni 106 - Gjobat lidhur me mos instalimin e PEF/SF

- Janë përcaktuar gjobat në rastet kur nuk instalohen PEF/SF, si:
 - gjobë prej dyqindpesëdhjetë euro (250.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor deri në tridhjetëmijë euro (30,000.00€);
 - gjobë prej pesëqind euro (500.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga tridhjetëmijë euro e një cent (30,000.01€) deri në dyqind mijë euro (200,000.00€);
 - gjobë prej njëmijë euro (1,000.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga dyqind mijë euro e një cent (200,000.01€) deri në pesëqind mijë euro (500,000.00€);
 - gjobë prej dymijë euro (2,000.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga pesëqind mijë euro e një cent (500,000.01€) deri në pesë milion euro (5,000,000.00€); dhe
 - gjobë prej tremijë euro (3,000.00€) për tatimpaguesin me qarkullim vjetor prej pesë milionë euro e një cent (5,000,000.01€) e më shumë.

Neni 107 - Gjobat për Operatorët Ekonomik të autorizuar për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të PEF/SF

- Është shtuar nen i ri përmes të cilit janë përcaktuar gjobat për Operatorët Ekonomik të autorizuar për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të PEF/SF.
 - 1. Operatori Ekonomik i nënshtrohet gjobës prej njëqindpesëdhjetë euro (150€), si në vijim:
 - 1.1. në rastin kur nuk instalon PEF/SF brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës nga tatimpaguesi;
 - 1.2. në rastin kur nuk instalon PEF/SF edhe pas aplikimit të gjobës sipas nën paragrafit 1.1 të paragrafit 1 këtij neni, gjoba përsëritet për çdo vonesë pesëmbëdhjetë (15) ditore të mëtutjeshme;
 - 1.3. në rastin kur nuk kryen servisimin apo intervenimin në PEF/SF brenda dyzetetë (48) orëve nga afati për servisim apo kërkesa për intervenim;
 - 1.4. në rastin kur nuk kryen servisimin apo intervenimin në PEF/SF edhe pas aplikimit të gjobës sipas nën paragrafit 1.3 të paragrafit 1 këtij neni, gjoba përsëritet për çdo vonesë prej dyzetetë orëve (48h) të mëtutjeshme; dhe
 - 1.5. në rastin kur gjendet një PEF/SF e instaluar tek tatimpaguesi, e cila nuk i përmbush kërkesat funksionale dhe teknike, të përcaktuara me akt nënligjor.
 - 2. Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk e vazhdon garancionin bankar deri në njëzetekatër orë (24h) para skadimit, ATK ekzekuton garancionin.

Neni 109 - Gjoha për mallrat pa dokumentacion

- Kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa dokumentacion për blerjen e tyre, ai person i nënshtrohet gjobës prej tridhjetë përqind (30%) të vlerës së tregut të atyre mallrave. Pra, është ndryshuar përqindja e gjobës nga 25% në 30%.

Neni 110 - Zbritja e gjobave

- Është riformuluar neni Zbritja e gjobave.
- Është shtuar dispozita e cila përcakton se aty ku tatimpaguesi me detyrim tatimor të pashlyer, paguan detyrimin tatimor së bashku me interesin me një pagesë të njehershme, gjobat e aplikuar sipas këtij Ligji, përveç gjobave të aplikuar për mosdorëzim të pasurisë që i nënshtrohet masës së marrjes si dhe lënies mënjane të parave, do të zbriten në tridhjetë përqind (30%).
- Është shtuar dispozita e cila përcakton se aty ku tatimpaguesi me detyrim tatimor të pashlyer, hyn në marrëveshje me shkrim për të paguar tatimin e pashlyer me dy ose më tepër këste, i përmbush kushtet e marrëveshjes me shkrim, dhe i kryen në kohë të gjitha detyrimet e tjera tatimore gjatë kohës së asaj marrëveshjeje, gjobat e aplikuar sipas këtij Ligji, përveç gjobave të aplikuar për mosdorëzim të pasurisë që i nënshtrohet masës së marrjes si dhe lënies mënjane të parave, do të zbriten në pesëdhjetë përqind (50%).

Neni 110 - Zbritja e gjobave

- Është shtuar dispozita që për çdo ndëshkim të aplikuar sipas këtij Ligji, përveç gjobave të aplikuara për mosdorëzim të pasurisë që i nënshtrohet masës së marrjes si dhe lënies mënjane të parave, nëse paguhet brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e njoftimit për aplikim të gjobës, paguhet vetëm pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së gjobës të aplikuar.
- Është shtuar dispozita që në rastet kur tatimpaguesi raporton keqpërdorimin dhe ofron prova të mjaftueshme se një zyrtar tatimor ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, Drejtori i ATK mund të nxjerrë vendim që tatimpaguesit t'i lejohet korrigjimi i deklaratës tatimore brenda afatit tre (3) muaj pa qenë subjekt i ndëshkimeve të përcaktuara me këtë Ligj.

Neni 111 - Ankesat në Administratën Tatimore të Kosovës

- Është shkurtuar afati për shqyrtimin e ankesës nga ATK, nga 60 ditë në 45 ditë.

Neni 112 - Ankesat në Bord

- Është shtuar nen i ri: Ankesat në Bord, ku pala e pakënaqur me vendimin e Njesisë së Ankesave në ATK apo të Njesisë së Ankesave në Doganën e Kosovës, mund të parashtroj ankesë në Bord.

Neni 113 - Përmbajtja e ankesës në Bord

- Është shtuar nen i ri: Përmbajtja e ankesës në Bord.

Neni 114 - Barra e provës

- Është shtuar nen i ri: Barra e provës.

Neni 115 - Procedura e Bordit

- Është shtuar nen i ri: Procedura e Bordit.

Neni 116 - Marrëveshja tatimore

- Është shtuar nen i ri: Marrëveshja tatimore.

Neni 117 - Obligimi për të paguar detyrimin tatimor gjatë procedurës së ankesave

- Është riformuluar neni: Obligimi për të paguar detyrimin tatimor gjatë procedurës së ankesave.
- Është shtuar dispozita e cila përcakton se paraqitja e ankesës në Njësinë e Ankesave dhe në Bord, si dhe paraqitja e padisë në gjykatën kompetente nuk pezullon obligimin për pagesë të detyrimeve tatimore. Pra, këtu është rikthyer dispozita e cila është fshirë me Ligjin Nr. 08/L-176 sipas të cilës përderisa tatimpaguesi ishte në procedurë të ankesës, ATK nuk kishte të drejtë të zbatonte procedurat e mbledhjes së tatimit.

Neni 118 - Rregullat ndërkombëtare

- Është riformuluar neni lidhur me Rregullat ndërkombëtare apo siç është i emëruar në Ligjin Nr. 03/L-222 Masat e përkohshme Ndërkombëtare.

Neni 119 - Dispozitat Kalimtare

- Është shtuar nen i ri “Dispozitat kalimtare”, sipas të cilit:
- Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, të gjitha ankesat me këtë Ligj dorëzohen në Bord gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.
- Divizioni Fiskal pranë Gjykatës përkatëse vazhdon të trajtojë të gjitha ankesat e pranuar deri në hyrjen në fuqi të këtij Ligji, si dhe t’i pranoj ankesat edhe për gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.
- Të gjitha procedurat e iniciuara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji zhvillohen sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi në kohën e inicimit të atyre procedurave.

Neni 120 - Plotësimi dhe ndryshimi i Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

- Është shtuar nen i ri “Plotësimi dhe ndryshimi i Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik”, sipas të cilit është përcaktuar që pas hyrjes në fuqi të Ligjit, bëhet përcaktimi i klasës së pagës që zbatohet për funksionet, pozitat apo emërtesat e të punësuarve të Administratës Tatimore të Kosovës, në bazë të dispozitave të ligjit përkatës për Pagat në Sektorin Publik, e cila është ekuivalente në pajtueshmëri me “Shtojcën nr. 6.1 – Dogana e Kosovës” të Ligjit përkatës të Sektorit Publik”.
- Ky nen fillon të zbatohet pas miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Tatimore të Kosovës”.

Vëmendje:

- Në përgjithësi në tërë Ligjin Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, janë bërë riformulime të disa paragrafëve me qëllim që të jenë qartë të kuptueshme, si dhe janë bërë përmirësime edhe në gabime gjuhësore.

Vizitoni ueb faqen
e ATK-së
www.atk-ks.org

Ju faleminderit për
vëmendjen tuaj!

Open Data Raporto 0800 80 800

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracjia Kosova
Tax Administration of Kosovo

Shqip

Ballina e-Shërbime Për tatimpaguesit Legjislacioni dhe Marrëveshjet Publikime Galeria FAQ

Mbledhja e tatimeve dhe kontributeve mbështet zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Shërbimet Elektronike

- EDI - Deklarimi Elektronik
- Raporto blerjet mbi 500 Euro
- Libri i blerjes dhe i shitjes
- Vërtetimi Tatimor
- Fjalori terminologjik
- Verifikimi i regjistrimit nga punëdhënësi
- Kalkulatori i pagave
- Kërko tatimpaguesin
- Shkarko deklaratën elektronike

Informatat

- Tatimet
- Arkat fiskale
- Numrat fiskal
- Pensionet
- Tatimpaguesit jo-aktiv
- Mbledhja e detyrueshme
- Lista e Vërtetimeve Tatimore të anuluar nga ATK
- Avokati i tatimpaguesve
- Informata të përgjithshme mbi tatimet
- Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime

Vegëzat e jashtme

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
- Dogana e Kosovës
- Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF)